



VENDIM

Nr. 144 Datë 07.12.2011

PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KESH SH.A PËR PERIUDHEN E TRETË
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

Vendosi:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012 - 2014), do të jete 1.00 leke/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI